



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.48, datë 28.09.2007

**“PER NJË SHITESË FONDI INVESTIMESH, PËR RIKONSTRUKSIONIN
E GODINËS SË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TAKSAVE DHE
TARIFAVE VENDORE
(FAZA E DYTË)”**

Bazuar në ligjin Nr.8652, datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore”, neni 32, germa “dh” ndryshuar me Ligjin Nr.9208, datë 18.03.2004, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.23 datë 30.04.2007 “Për miratimin e realizimit të Buxhetit të vitit 2006 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2007”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.38, datë 26.06.2007 “Mbi kalimin kapital të zyrave të Uzinës Mekanike “Tirana”, Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I

1. Të miratojë vleftën e plotë të objektit “Rikonstruksion i Zyrave të Administratës së Taksave dhe Tarifave” në shumën **85.305.300 lekë** nga të cilat:

a. Ndërtim montim	83.980.000 lekë
b. Mbikqyrje punimesh	1.224.500 lekë
c. Kolaudim	100.800 lekë

2. Të miratojë shtesën e fondit për investime për vitin 2007 për objektin “Rikonstruksion i Zyrave të Administratës së Taksave dhe Tarifave Vendore”(Faza e dytë) në shumën **62.305.300 lekë**, nga të cilat;

a. Nërtim montim	61.480.000 lekë
b. Mbikqyrje punimesh	754.500 lekë
c. Kolaudim	70.800 lekë

3. Efektet financiare të shtesës së fondit sipas pikës 2 të Vendimit, të përballohen duke pakësuar fondin rezervë të miratuar në Buxhetin e vitit 2007, në po këtë shumë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, Drejtoria e Përgjithshme e Urbanistikës, Drejtoria e Prokurimit Publik, Drejtoria e Financës.
5. Ky vendim, hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SOKOL DERVISHAJ

K R Y E T A R